



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit, mbajtur më 10.11.2020, (përmes platformës online - ZOOM), e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Adrian Berisha (PSD), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Valbona Petrovci (e pavarur), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (i pavarur) dhe Granit Shala (Nisma).

Munguan: Migjen Shala (PDK) dhe Kreshnik Smajlaj (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Eroll Raskova, përfaqësues i Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, kryesuesi falënderoi përfaqësuesin e DEMOS-it për mbështetjen dhe ndihmën për realizimin e mbajtjes së mbledhjes përmes platformës “ZOOM”. Njëherësh ai propozoi që pika e pestë e rendit të ditës:

“Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri)Thaçit dhe Sevdail (Bajram)Dakut, të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet ligjore.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Egzon Azemi propozoi që pika e tetë e rendit të ditës: *"Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë, të hiqet nga rendi i ditës, pasi që kjo pronë duhet të parcelohet në dy pjesë, pra që 12 mijë metra katrorë i takojnë NPB-së, kjo duhet të jetë me dokument e jo vetëm të votojmë, kur nuk e dimë se çka po votojmë dhe sa metra katrorë po ia lëmë NPB-së, e sa pjesë po i mbetet Komunës së Prishtinës.*

Dren Kukaj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve të NPB-së, tha se kjo pikë duhet të mbetet brenda rendit të ditës dhe të votohet, ku dhe kërkoi që asambleja ta shpreh vullnetin e vetë që t'ia japë pronën NPB-së.

Halim Halimi propozoi që në rend të ditës të futet pika: *"Propozimvendimi për kompensimin e shujtës për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës".*

Lidhur me këtë propozim, kryesuesi tha se përderisa ekziston një vendim i tillë, konsideroj se mund të merret si vendim i dyfishtë.

Leutrim Retkoceri tha se duke pasur parasysh gjendjen dhe situatën në të cilën jemi, t'i motivojmë qytetarët të cilët e përdorin trafikun urban, apo transportin publik, ta bëjmë pa pagesë, duke i nxitur në këtë formë qytetarët që t'i përdorin më pak makinat e tyre dhe të shfrytëzojnë trafikun urban.

Njëherësh ai propozoi që të futet në rend të ditës edhe pika: *"Propozimvendimi për lirim të qytetarëve pa pagesë në trafikun urban për periudhën nëntor- mars".*

Mustafë Krasniqi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale, propozoi që në rend të ditës të futet pika: *"Propozimvendimi për caktimin e kompensimit të aksionareve të ndërmarrjeve publike lokale".*

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se sa i përket propozimit të z. Halimi, ekzekutivi ka pasur gatishmëri, por kjo nuk varet prej neve. Ne si ekzekutiv mund t'i dërgojmë edhe një herë kërkesë Qeverisë, nëse ajo na lejon që ta bëjmë pagesën e shujtës.

Po ashtu, sa i përket çështjes së ngritur nga Leutrimi, duhet ditur se ne nuk mund ta bëjmë sot për sot, për shkak se pagesa e Trafikut Urban është e shënuar në Ligjin për kredi, që e kemi marr nga BERZH-i. Megjithatë, në çiftë se shkon kjo falas, atëherë ngrihen shumë shpenzimet në "mallra dhe shërbime", të cilat po ashtu kanë kufi dhe ashtu janë të caktuara nga Ministria e Financave.

Sami Boroci tha se duke pasur parasysh argumentet që i dha kryetari rreth propozimit të z. Retkoceri, propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse me këto propozime "ad hoc", nuk mundemi me marrë vendime të duhura pa pasur një material të artikuluar dhe të analizuar mirë dhe të detajuar, i cili sqaron krejt, edhe çështjet ligjore.

Rifat Deri shprehu mendimin se Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë, të mbetet në rend të ditës për diskutim.

Vala Peshku tha se Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë, nuk duhet të largohet nga rendi i ditës, por të procedohet. Po ashtu, sa i përket propozimit të z. Leutrim Retkoceri dhe z. Mustafë Krasniqi, tha se kisha pasur dëshirë që kur të sjellim propozime për pika të tilla, gjithmonë ta kemi parasysh edhe implikimin financiar.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.

Kryesuesi konstatoi se më 10 vota për, 20 vota kundër dhe 10 abstenime, nuk u miratua propozimi që *“Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë”*, që të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për, 14 kundër dhe 6 abstenime u miratua propozimi, që *“Propozimvendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, për periudhën nëntor- mars”*, hyn në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 5 abstenime, u miratua propozimi që *“Propozimvendimi për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale”*, hyn në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që *“Informata nga Kryetari i Komunës rreth menaxhimit të situatës së pandemisë Sars-COVID- 19 në komunën e Prishtinës”*, hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 1 abstenim, me ndryshimet e bëra, u miratua ky

R E N D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit;
2. Informatë nga Kryetari i Komunës rreth menaxhimit të situatës së pandemisë Sars-COVID-19 në komunën e Prishtinës;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2020 (TM3);
4. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta;

7. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjës "Kalabria", pjesa e kolektorit;
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e margjinalizuara;
10. Propozimvendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, për periudhën nëntor-mars;
11. Propozimvendimi për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve të NPL-ve;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Pika e dytë

Informatë lidhur me situatën e pandemisë COVID - 19 në Prishtinë.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se këto ditë kemi pasur një rritje të numrit të të infektuarve, por në të njëjtën kohë, kemi pasur edhe rritje të numrave të testimeve. Deri më sot në Prishtinë kemi 8909 raste, 6057 të shëruar, 2761 janë aktivë dhe 91 viktima, deri më sot. Duke pasur parasysh këtë gjendje, Prishtina është futur në zonën e kuqe, ku parashihen masa kufizuese më të rrepta. Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen "Emshiri" (Kalabria), kemi vendosur që ta bëjmë Qendër për shërbimin për të infektuar që kërkojnë ndihmë mjekësore, që nuk janë për Klinikë Infektive. Sa i përket shkollave, edhe pse kemi qenë skeptik rreth këtij plani të zbatimit të skenarëve A,B,C, pra në momentin që kemi të infektuar në një shkollë dhe rastet janë të pakta, e mbyllim klasën. Ndërsa në momentin kur më shumë se 5% e stafit të shkollës infektohet, atëherë e tërë shkolla kalon në planin C, apo online dhe mbyllet shkolla. Sa i përket dhënies së ndihmave, tha se ndoshta në një të ardhme të afërt, do të na nevojitet ta diskutojmë edhe një pako tjetër, pra do ta diskutojmë edhe gjendjen financiare.

Sami Boroci u shpreh kundër një mbylljeje klasike, dhe sugjeroi që të punohet më shumë në vetëdijesimin e qytetarëve për respektimin e masave, çoftë në sektorin e gastronomisë, çoftë në ndërmarrjet publike private, të gjitha këto sepse besoj se i gjithë infektimi po vjen pikërisht prej këtyre sektorëve. Sa i përket fondit prej 5 milionë euro, kërkoj që në kuadër të krejt procedurave që kanë me u zhvilluar rreth zbatimit të kësaj pakoje, të jetë edhe një mbikëqyrje prej Kuvendit komunal.

Po ashtu, kërkoi që nëse ka bazë ligjore, monitorues i kësaj pakoje të jetë edhe një komision apo grup i përbërë prej përfaqësuesve të partive politike.

Agim Gashi tha se këshilla ime për administratën komunale është, që në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen "Kalabria", ku trajtohen të infektuarit me COVID -19, do të ishte mirë që të plotësohen disa kushte elementare për trajtimin e tyre, siç është shkurtimi i kohës në procesin administrativ, sepse një pacient fillestar aty do t'i humbte së paku njëzet minuta në ata formularë kur plotësohen.

Nuk mund të konsiderojmë ndihmë, në çoftë se një i infektuar i bënë 5-6 analiza elementare, ndërsa dy më të rëndësishme për COVID-19 detyrohet të shkojë në një laborator privat. Do të ishte mirë që ndihma më e madhe të iu ofrohet aty për aty, ajo çka ka mundësi në shërbimet elementare, dhe vetëm atëherë mund të konstatojmë se ne po ofrojmë një shërbim të mirëfilltë.

Leonora Shabani ngriti një shqetësim lidhur me ankesat e nënave të fëmijëve të cilët e ndjekin mësimin online, e cila tha se duke e ditur gjendjen e kushteve ekonomike në shumicën e familjeve, e kanë të pamundur t'u ofrojnë mësimin online fëmijëve të tyre, për shkak të mungesës të mjeteve elektronike, ipad apo tablet. Një kohë Komuna ka shpërndarë për familjet në nevojë këtë lloj teknologjie, nuk e di se a qëndron ende ky projekt apo jo.

Leutrim Retkoceri shtroi pyetjen se çka do të ndodhë nëse do të ketë një numër më të lartë të qytetarëve të infektuar, dhe a do ta përballojnë QMF-të atë fluks, dhe nëse merr një kohë me temperaturë të ultë, atëherë qysh kanë me u ballafaquar QMF-të për pranimin e qytetarëve të Prishtinës dhe për kontrollet e para që ata kanë me iu dhënë. Ndërsa sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, jemi duke parë që është një menaxhim sporadik i situatës dhe kjo masë nuk i konvenon kryeqytetit dhe qytetarëve të Prishtinës.

Shefki Gashi tha se masat të cilat janë propozuar nga ekspertët e Qeverisë dhe nga Ministria e Shëndetësisë, e cila me tanë punën që është duke bërë ka arrit ta mbajë në kontroll gjendjen shumë të rëndë të pandemisë që ka kapluar botën. Jam pak i indinjuar që Prishtinën e kanë futur në zonën e kuqe, dhe këto masa janë të ashpra, andaj kisha kërkuar të ngrihet për një shkallë më të lartë, që të mos bllokohet biznesi, mos të bllokohet jeta, aktivitetet në Prishtinë. E përkrah idenë e kryetarit, që Prishtina të mos kategorizohet në zonën e kuqe.

Arbër Vokri tha se përveç pajisjeve mbrojtëse për stafin punues, që janë furnizuar QMF-të, po ashtu kemi nevojë edhe për shumë staf mjekësor. Do të ishte më se e domosdoshme që Kuvend komunal të ushtrojë më shumë presion në instanca më të larta në Qeveri dhe në Ministrinë e Financave, ku duhet të lejohet punësimi një numri të personelit mjekësorë për përballimin e situatës.

Andaj, nëse Prishtinën e shënojnë si zonë të kuqe Ministria ose Qeveria, atëherë le ta kenë parasysh se për ta ndryshuar këtë ngjyrë, duhet me pranuar personel shëndetësor aq sa është i nevojshëm.

Vala Peshku tha se ne duhet t'i japim një përkrahje kryetarit të Komunës në raport me Ministrinë e Shëndetësisë, pra të jetë kjo një lloj revolte për trajtimin që po i bëhet Prishtinës. Që nga muaji mars, vetëm Prishtina ka qenë nën llupën e organeve vendimmarrëse për çështjen e COVID-19, përderisa në një dalje prej Prishtinës në disa lokale, që nga marsi ke mundur me pi kafe, e aty janë mbajtur edhe ahengje të tjera, si dasma, andaj kjo është mjaft evidente dhe na bën me dije se çka po ndodh në këto qytetet tjera.

Mimoza Sylejmani tha se në QKMF bëhen të gjitha analizat, e them këtë pasi që edhe unë isha e infektuar me COVID -19. Mendoj se edhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen "Kalabria" kryhen pothuajse të gjitha analizat që janë të nevojshme.

Vlora Dumoshi u shpreh se ne po përballemi me një situatë, e cila vërtetë është e paparashikueshme, por mund të them se edhe Komuna e Prishtinës e ka menaxhuar vërtet shumë mirë, me të gjitha kapacitetet që ka pasur, dhe vërtetë është për t'u përshëndetur edhe me ndihmat të cilat janë shpërndarë. Mendoj se nuk duhet me u anashkaluar vendimet, të cilat merren për disa ditë ose për një javë, me u respektuar, që mos të bëhet përhapja e këtij virusi.

Rifat Deri tha se edhe ne jemi kundër asaj që Prishtina të jetë në zonën e kuqe. Krahas kësaj kemi probleme edhe më të mëdha, sepse janë duke u sjellë edhe viruse të tjera, kështu që do të kemi komplikime edhe më të mëdha. Kjo situatë më së shumti po i atakon bizneset, kështu që shteti dhe Komuna duhet ndihmuar atë kategori.

Suzan Kika theksoi se nuk jemi aspak të pajtimit që Prishtina të futet në zonën e kuqe, sepse secila mbyllje po kushton për secilën fushëveprimtari.

Duhet analizuar mirë këto masa të cilat po merren, pra duhet shikuar mirë se cilat po merren dhe cilat janë më efektive, dhe nëse nuk japin efekt pse të vihen këto kufizime. Mendoj se gjithmonë duhet të shkojmë me rekomandime, d.m.th të mbahen maskat, dezinfektimi i duarve e të tjera, e jo të merren kufizime të tilla të cilat nuk japin efekte.

Halim Halimi tha se ne të gjithë e dimë se në shkollat e Prishtinës është një numër i arsimtarëve, të cilët vuajnë nga sëmundje të llojllojshme, si sëmundje kronike, kancer etj. dhe për këtë është ndar një fond i veçantë buxhetor për arsimtarët, që të zëvendësohen me arsimtarë të tjerë sidomos gjatë kohës së pandemisë.

Ai kërkoi të dijë se Komuna e Prishtinës a është duke ndërmarrë diçka në këtë drejtim, apo ka ndërmarrë, pasi që mjetet janë ndarë nga Ministria e Financave.

Naim Hoxha tha se një çështje e rëndësishme në këtë problemin e pandemisë është çështja e disiplinës së qytetarëve. Unë kam hasur në shumë shitore, ku shitësit nuk sillen konform nevojës edhe kërkesës dhe nuk vendosin maska. Mendoj që duhet të bëhet një presion shumë më i madh te qytetarët dhe të gjithë ata, posaqërisht ata që kryej shërbime, të cilët nuk i rrespektojnë këto rregulla dhe këto norma që janë përcaktuar. Prandaj, kisha apeluar që të kërkohet një profesionalizëm më i mirë, sepse është fjala për çështje elementare. Mendoj se duhet të kemi kujdes për Prishtinën, sepse ka një karakter krejt tjetër prej qyteteve të tjera.

Lidhur me vërejtje dhe sugjeimet e dhëna rreth menaxhimit të pandemisë në komunën e Prishtinës, sqarime shtesë dha **Shpend Ahmeti**, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata lidhur me situatën e pandemisë COVID - 19, në Prishtinë.

Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2020 (TM3)

Halimi Halimi tha se sa u përket të hyrave të Komunës së Prishtinës, në këtë tremujor janë grumbulluar të hyra në shumën prej 7 milionë e 576 mijë euro, ku është bërë një realizim prej 25.9 %. Sa i përket të hyrave tatimore dhe atyre jo tatimore, kanë shënuar një rënie të dukshme prej 15.19%, gjë e cila nuk është e kënaqshme, por duke pasur parasysh situatën pandemike, arsyetohet deri diku. Po ashtu, sa i përket shpenzimeve komunale, shpenzimet buxhetore gjatë periudhës së TM 3, kanë arritur një shumë prej 19,339,767.00 euro, apo 5.48 % më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nëse shikojmë me radhë drejtoritë, mund të konstatojmë se disa nga drejtoritë komunale gjatë kësaj periudhe kanë zero shpenzime, e disa të tjera me një përqindje të shpenzimeve jashtëzakonisht të ulët. Mendoj se me këtë trend të shpenzimeve, për vitin e ardhshëm do të barten diku rreth 30 milionë euro së paku, gjë e cila nuk është e pranueshme për një komunë si është Komuna e Prishtinës.

Mirsad Vitia tha se pothuajse në të gjitha drejtoritë komunale realizimi i buxhetit është në një përqindje shumë të vogël. Në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale realizimi i buxhetit ka qenë vetëm 1.35%, e që konsideroj se është mjaft shqetësuese. Në Drejtorinë e Kulturës realizimi i buxhetit ka qenë vetëm 16.12%, mendoj se është një realizim shumë i vogël. Në Drejtorinë e Sportit dhe Rekreacionit, nga 1 milion e 500.000 euro, kanë mbetur të pa shfrytëzuara, e që është jashtëzakonisht shqetësuese. Po ashtu, edhe në Drejtorinë e Arsimit, me një buxhet prej 2.2 milionë euro, ka mbetur të buxhetit të pashfrytëzuar rreth 1 milion e 900.000 euro. Është për t'u shqetësuar se edhe në Drejtorinë e Bujqësisë është zero për qind realizimi i buxhetit.

Duke pasur parasysh një raport të tillë, Grupi ynë nga LVV nuk do ta votojnë këtë raport. **Leutrim Retkoceri** tha se Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, TM 3, është jashtëzakonisht i dobët. Duke e marrë parasysh pandeminë, mund ta kuptojmë deri diku rënien në të hyra dhe në disa planifikime, por assesi nuk është edhe nuk kuptohet se si kemi një realizim kaq të dobët. Është shqetësuese se si deri me tani janë realizuar vetëm 40% të buxhetit të Komunës së Prishtinës. Kjo dëshmon edhe një herë për një mungesë të vizionit edhe për një seriozitet në angazhimin e kësaj qeverisje, që buxhetin ta realizoj në mënyrë sa më të mirë për qytetarët e Prishtinës, dhe nëse shikojmë se sa mjete janë duke tepruar, ku 60% e buxhetit ende nuk është realizuar. Është shqetësuese se disa drejtori të Komunës kanë zero buxhet të realizuar dhe disa të tjera me një përqindje shumë të vogël të realizimit të buxhetit.

Vala Peshku tha se ne që nga muaji mars jemi në pandemi, kisha dashtë me i korrigjuar disa kolegë që po thonë faza e parë e pandemisë, faza e dytë e pandemisë, d.m.th. pandemia ka filluar në mars zyrtarisht dhe ende është aktive, e që fundi nuk i dihet.

Duke pasur parasysh situatën në të cilën jemi, nuk kam pasur pritje më të mira as për TM 3, as për TM 4, e as për pjesën e parë të vitit të ardhshëm, duke e konsideruar që jemi në pandemi.

Fiknete Bejta tha se buxheti i Republikës së Kosovës është miratuar diku me 5 muaj vonesë, edhe si pasojë e kësaj është vonuar edhe realizimi i projekteve, e që ka ndikuar edhe në procedurat e tenderimit, sepse Ministria e Financave i ka ndërprerë të gjitha procedurat e prokurimit për operatorët ekonomikë dhe zhvillimin e projekteve. Po ashtu, mund të themi se në realizimin e buxhetit ka ndikuar edhe pandemia.

Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, tha se vonesa e miratimit të buxhetit në nivel të vendit, ka shkaktuar probleme të mëdha, sidomos rreth mosfunksionimit me kohë të prokurimit. Tani ne i kemi dorëzuar pjesën dërmuese të projekteve në prokurim, të parapara sipas planit të prokurimit, dhe jemi duke pritur që të realizohen të gjitha ato.

Agim Gashi tha se për mua është shqetësuese se as vlerën e mjeteve të bartura nga viti paraprak nuk ka arritur qeveria komunale t'i shpenzojë. Mendoj se as në tremujorin e katërt, faktikisht në fund të vitit nuk do të arrijë ta shpenzojë as 23 milionëshin e bartur. Të gjitha mjetet e bartura janë projekte të kontraktuara dhe nuk janë realizuar. Po ashtu, as subvencionet e planifikuara në fusha të ndryshme nuk janë realizuar. Drejtoritë me zero buxhet shpenzime, apo me buxhet minimal të shpenzimit, ato nuk kanë kuptim se funksionuari në këtë qeveri. Ka edhe arsye të tjera që këshilltarët janë të brengosur dhe i shprehin pakënaqësitë e tyre sa i përket këtij raporti, por do të ishte mirë që mobilizimi me kapacitetet që i ka qeveria komunale, të jetë në shkallën më të lartë dhe ta shfrytëzojmë këtë mot të mirë që po na merr dhe të shpërndahen mjetet për fushat të cilat i kemi planifikuar dhe i kemi votuar.

Rifat Deri tha se përderisa është në fuqi ky ligj i prokurimit, asnjëherë punët nuk do të përfundojnë si duhet. Fati është që e kemi një ligj të prokurimit shumë të keq dhe i cili i mundëson që gjithmonë të fitojë kompania e cila e ka çmimin më të ulët. Besoj që në tremujorin e fundit Komuna e Prishtinës do të angazhohet sa më shumë me përfundimin e projekteve të cilat i ka filluar në këta mujorët e parë.

Egzon Azemi tha se nuk qëndron arsyetimi që viti pandemik e ka pamundësuar shfrytëzimin e buxhetit. Këtu duhet të jemi realist, nëse i krahasojmë shpenzimet e këtij viti pandemik dhe të kaluarit, që nuk ka qenë vit i tillë, e shohim se më shumë buxhet tek investimet kapitale është investuar gjatë kësaj periudhe sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Komuna e Prishtinës edhe sipas raporteve të përsëritura të auditorëve, nuk po i rrit vetë të hyrat, siç është Zona industriale e Prishtinës, e që në atë zonë kryesisht gjenerojnë fitime të mëdha. Bizneset në atë pjesë ku kanë miliona euro qarkullim dhe Komuna duke mos marrë qiranë nga këto biznese për shfrytëzimin e asaj hapësire komunale, i humb sipas raportit 360.000 euro në muaj, kështu që nuk guxojmë që pandeminë ta përdorim vetëm si arsyetim, sepse po e shohim që si trend fatkeqësisht ka qenë mosshfrytëzimi i buxhetit.

Kryesuesi konstatoi se më 15 vota për, 16 kundër dhe 2 abstenime, nuk u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2020 (TM 3).

Pika e katërt.

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike, lidhur me projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Leonora Shabani- Bajraktari, lidhur me Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve, tha se kjo rregullore ka dalë prej ligjit, i cili i obligon komunat që ta bëjnë një ekip për mbrojtjen e fëmijëve, ku Komuna e Prishtinës ende nuk e ka krijuar këtë ekip.

Në disa institucione, shkolla kemi hasur në ngacmime seksuale, në kërcënime, kemi hasur edhe në shantazhime nga mësimdhënësit për fëmijët, sa që në institucion si nivel komunal, si nivel i qeverisjes komunale ne duhet me reaguari. Fëmijët me aftësi të kufizuar në asnjë shkollë nuk kanë qasje, përveç disa asamblistë këtu që jemi angazhuar dhe e kemi bërë një qasje tek gjimnazi "Eqrem Çabej". Ne si institucion duhet të punojmë edhe më shumë për këtë kategori të fëmijëve, që ata të kenë një qasje sa më të lehtë në jetën e tyre.

Në emër të Grupit të LVV-së, e përkrahim këtë rregullore.

Suzan Kika tha se për mua si përfaqësuese e qytetarëve dhe si një nënë, ka rëndësi të madhe që fëmijëve t'u sigurohet një jetë brenda standardeve mesatare që ka Prishtina. Për këtë mendoj se duhet të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale. Mendoj se pas miratimit të kësaj projektregulloreje nuk do të krijohet ky standard, ngase ne së pari, nuk kemi informacione të mjaftueshme, nuk kemi vijë buxhetore të mjaftueshme dhe nuk i shfrytëzojmë të gjithë mekanizmat tanë për parandalimin e diskriminimit, abuzimit, detyrimet dhe shfrytëzimet tjera që u bëhen kësaj kategorie të fëmijëve.

Agim Gashi tha se është për ta përshëndetur këtë akt ligjor, i cili rregullon këtë fushë shumë të rëndësishme, por duhet të rikujtojmë se administrata komunale po merr një barrë tejet të rëndë, e cila ka një kosto jo vetëm profesionale, por edhe financiare.

Së paku unë, do ta uroja administratën komunale që ta përmbushë një obligim që e parasheh kjo rregullore për të gjitha këto segmente dhe kategori të botës fëmijërore, të cilët janë pa mbrojtje familjare, pa mbrojtje institucionale, pa kushte elementare jetësore.

Do ta votoj këtë projektregullore, sepse shpresoj që kjo nëse asgjë nuk do të ndikoj, do të na kujtoj që njëherë në vit t'u bëjmë presion shërbimeve përkatëse, të bëjnë për aq sa është e mundur në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Mimoza Sylejmani tha se jam shumë e lumtur që erdhi një rregullore, ku duhet të diskutohet, të dalë në diskutim publik, pastaj të votohet. Por, unë doja të diskutoja rreth asaj që u potencua nga parafolesja, e cila tha se në asnjë shkollë nuk ka qasje për persona me nevojë të veçanta. Mendoj që nuk qëndron ky konstatim. Unë, personalisht, në mandatin e parë dhe të dytë jam përpjekur dhe në shumicën e shkollave ku ka pasur pjerrina, jemi përpjekur që t'u ofrojmë qasje atyre fëmijëve, andaj nuk mund të thuhet që nuk ka në asnjë shkollë qasje, kjo nuk qëndron.

Naim Hoxha u shpreh se ne si shoqëri duhet ta sigurojmë një brez të ri të fëmijëve të shëndoshë, të kulturuar, të civilizuar për me mundur me pasur një perspektivë, e këtë nuk e kemi, sepse e kemi një grua e cila është e mbingarkuar, e cila nuk mund t'i realizojë të drejtat e veta, sepse duhet të kujdeset për fëmijë.

Do të kishte qenë mirë që kryetari i Komunës, ose cili do që të vij pas tij, ta ndërtojë një çerdhe, ku të gjitha gratë që i kanë fëmijët e vegjël mund t'i lënë aty pranë vetes, të punojnë gjatë orarit të punës dhe të kthehen në shtëpi pa ngarkesë se do ta lë fëmijë vetëm. Prandaj, të drejtat e fëmijëve janë çështje e civilizimit, pra është një çështje ku do ta vendosim ne vetën në rendin e këtyre kombeve të civilizuar që janë sot.

Vala Peshku u shpreh se ne gjithmonë po e kemi diskutimin e njëjtë, që për shtimin e numrit të punëtorëve civilë në Komunën e Prishtinës, gjithmonë është problematike rritja e numrit të tyre. Do të ishte mirë që të shihet mundësia e gjetjes së donatorëve, që do të na mundësonin t'i kemi psikologët dhe logopedët, apo pse jo edhe punë vullnetare. Jam e gatshme të ulem me asamblastët edhe të shikojmë të bëjmë një iniciativë, si Kuvend komunal, për këtë çështje.

Rifat Deri tha se ne për këtë pikë duhet të jemi të gjithë së bashku, të ndihmojmë, t'i japim detyrë Drejtorisë së Arsimit që kjo çështje të realizohet sa më shpejt. Para një viti është dashtë që ta kishim përfunduar këtë pjesë të projektregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Vlora Dumoshi theksoi se Kuvendi sot po e voton një projektregullore dhe do ta dërgojë në diskutim publik, pastaj do të votohet.

Për mua kjo pikë është shumë e rëndësishme që sot merr rrugë, dhe besoj që do ta përkrahim. Duhet me pasur kohë me marrë pjesë edhe në diskutimet të cilat do të zhvillohen.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 31 vota për u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike, lidhur me projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Agim Gashi theksoi se ky është një dokument i rëndësishëm, të cilin na e ka përgatitur GIZ-i gjerman, normalisht me bashkëpunëtorët e vetë në Komunën e Prishtinës, sepse është fushë që duhet zhvilluar për të përmirësuar sa më shumë jetën e qytetarëve të komunës sonë, por në këtë dokument janë të pasqyruara statistikën e vjetra. Do të ishte mirë që të bëhen përmirësime, në mënyrë që të mos miratojmë një dokument, i cili bazohet në statistika të vitit 2018. Pra, ky dokument të korrektohet dhe ato statistika të jenë kontabël me kohën kur dokumenti votohet.

Rifat Deri tha se ky dokument që na është prezantuar është i mjaftueshëm është hartuar mirë. Besoj që nëse kjo aprovohet, siç është shkruar, me ndihmën e GIZ-it, besoj që Prishtina ka me pasur shumë përfitime energjetike në bazë të këtij projekti që është bërë. Shpresoj shumë se kjo do të miratohet dhe do të zbatohet.

Naim Hoxha tha se eficienca është diferenca ndërmjet sasisë së energjisë që e fusim në një sistem dhe asaj pune që del, pra ne të gjitha të mirat që i fusim në shtëpi, i përdorim dhe i konsumojmë ashtu siç duhet.

Nëse Komuna i kryen punët me më pak shpenzime, krijon gabime më pak dhe bën dëme të cilat i paguan me dëmshpërblime më pak, atëherë thuhet se është eficientë.

Është me rëndësi që të gjitha segmentet e jetës dhe aktivitetet të përfshihen në trajtimin e eficientës. Ne do të flasim për sektorin publik, sepse sektori privat e bën atë për interesin e vetë, kurse sistemi publik është diçka që duhet të bëhet në mënyrë të programuar.

Çështja e eficientës është problemi tjetër që ne duhet ta fusim konceptin e kursimit, në kulturën tonë të përgjithshme, prej parashkollorit deri te pensionistët. Nëse ne nuk kursejmë, atëherë do ta kemi shumë të vështirë që të bëjmë ndonjë far efience apo efekt të kursimit të ruajtjes së energjisë.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për eficientë të energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit, për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta.

Vlora Dumoshi theksoi se me vendosjen e kësaj shtatoreje do t'i bëjmë nder figurës së shquar, një njeriu të madh dhe familjes se tij, siç ishte Anton Çetta.

Me këtë rast falënderoj shumë Kryetarin e Komunës së Prishtinës për vendosjen dhe caktimin e lokacionit. Lokacioni i cili është paraparë është nder për gjithë qytetarët e Kosovës, pra ai do të vendoset tek Fakulteti i Filologjisë dhe kjo do të jetë një shënim shumë i mirë në këtë 100-vjetor të lindjes së prof. Anton Çettës.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket vendosjes së shtatores në lokacionin e propozuar, pra në atë lokacion tani janë duke u zhvilluar punimet për parkingun nëntokësor, andaj kërkoj nga ekzekutivi të dijë se pas sa kohësh ne do ta shohim të vendosur shtatoren e atdhetarit Anton Çetta.

Arbër Vokri u shpreh në mbështetje të këtij propozimi për caktimin e lokacionit për shtatoren e profesorit Anton Çetta, por kërkoj që në mbledhjen e radhës së KPF-së të jetë në rend të ditës edhe kërkesa prej Lagjes së Muhaxhirëve dhe Shoqatës, të cilën e kanë adresuar në Komunën e Prishtinës për caktimin e një lokacioni për ndërtimin e një memoriali për golgotën e shqiptarëve të shekullit XIX nga sanxhaku i Nishit, Toplica etj.

Besnik Mujeci tha se ne si LVV e përkrahim këtë propozimvendim, por kërkoj që dokumentacioni të plotësohet edhe me fletën poseduese të lokacionit.

Ai shprehu mendimin se vendosja e kësaj shtatoreje në atë lokacion nuk është propozim i duhur, pasi që aty veç është përmendorja e prof. Fehmi Aganit.

Suzan Kika, duke marr parasysh se Anton Çetta ishte një njeri i vlerave, i urtësisë, e në veçanti një njeri i kulturës, do të ishte mirë që kjo shtatore të vendoset te Instituti Albanologjik, ngase aty e ka vendin ,dhe me vendosjen e kësaj shtatoreje te Instituti, ne do t'i bënim nder vendit, kombit dhe të gjithë intelektualëve që kontribuan në atë kohë, e posaçërisht familjes.

Rifat Deri u shpreh se vendi i propozuar është shumë adekuat, por besoj që edhe përmasat e shtatores do të jenë ashtu siç ka qenë edhe vet vepra e Anton Çettës.

Egzon Azemi tha se lokacioni i propozuar për momentin nuk mund të shfrytëzohet për këtë qëllim, sepse janë duke u zhvilluar punimet e parkingut nëntokësor dhe vendosja e një figure të tillë kombëtare, që është me një bagazh të madh, nuk ishte dashur me u vendos aty. Në atë lokacion është edhe shtatorja e prof. Fehmi Aganit, andaj nuk ishte dashtë që dy figura kaq të rëndësishme me qenë aq afër njeri-tjetrit. Edhe unë kisha propozuar që kjo shtatorë të vendoset te Instituti Albanologjik, andaj sugjeroj që të rishikohet edhe një herë çështja e këtij lokacioni.

Vala Peshku theksoi se lokacioni i propozuar për vendosjen e shtatores së Anton Çettës, edhe pse aty është e vendosur edhe shtatorja e prof. Fehmi Aganit, nuk e shoh si problem që u potencua nga parafolësit. Unë nuk e di a ka vend më të bukur dhe më domethënës edhe për Anton Çettën, edhe për Fehmi Aganin, e pse jo edhe për figura tjera sesa në oborrin e fakulteteve.

Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës bëri të ditur se janë propozuar disa lokacione për këtë shtatore, por për caktimin e lokacionit duhet të merret parasysh edhe dëshira e familjes. Nuk e shoh aspak problem vendosjen e shtatores në atë pjesë.

Sokol Berisha e përkrahu këtë propozimvendim për vendosjen e shtatores së Anton Çettës në lokacionin e propozuar.

Mimoza Sylejmani, lidhur me vendosje për lokacionin në fjalë, besoj se edhe në aspektin urbanistik është lokacion i qëlluar, sepse ka një shikueshmëri pothuajse nga të gjitha anët, andaj do ta votoj këtë propozimvendim për miratim.

Fiknete Bejta tha se si Grup i pavarur i asamblistëve, e votojmë këtë propozimvendim, që edhe përmendorja e prof. Anton Çetta të jetë në të njëjtën vijë me prof. Fehmi Aganin.

Adrian Berisha u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendim për miratim, duke shpresuar që ky projekt do të realizohet sa më shpejt.

Naim Hoxha, sa i përket lokacionit për vendosjen e shtatores së Anton Çettës, kemi edhe pjesë tjera, si p.sh. para Akademisë së Shkencave, Ministrisë së Arsimit, para Galerisë, po ashtu edhe në atë pjesën që gjendet nëpërmjet Fakultetit Ekonomik, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit të Arteve. Mund të jetë edhe para Bibliotekës, është shumë kuptimplote një përmendore para bibliotekës, që është simbol i arsimit, e në anën tjetër e kemi një njeri që ka kontribuar shumë për arsim.

Kisha propozuar që udhëheqësit e Komunës t'i marrë në konsiderata të gjitha këto opsione dhe ta gjejnë lokacionin më të mirë.

Naime Osmani tha se qe sa vite kemi pasur kërkesa nga qytetarë të ndryshëm dhe nga grupi i intelektualëve për vendosjen e shtatores së prof. Anton Çettës. Ne e kemi përjetuar dhe kemi qenë të kyçur në atë aktivitet gjithëpopullor me prijësin Anton Çetta, dhe po ndihem krenare që jam pjese e asamblesë në marrjen e një vendim kaq të rëndësishëm dhe historik.

Nol Nushi shprehu mendimin se vendosja e shtatores së prof. Anton Çetta afër shtatores së prof. Fehmi Aganit, nuk paraqet asnjë problem, andaj ju sugjeroj të gjithë asamblistëve që ta votojnë këtë propozim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit rreth lokacionit të propozuar për vendosjen e shtatores së prof. Anton Çettës, sqarime të nevojshme dha **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 31 vota për, u miratua **Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta**.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi **Genc Bashota**, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua **Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit**.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 6 kundër dhe 3 abstenime, u miratua **Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë**.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara.

Lidhur me Propozimvendimin për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se këtë çështje e kemi diskutuar me drejtorin, që të merret si një iniciativë apo si mbështetje e Komunës për organizatat që merren me fëmijët me nevoja të veçanta, e që këto organizata të obligohen të ofrojnë shërbime në shtëpi. Po ashtu, sa i përket Shoqatës së Autizmit, ku kjo organizatë nuk është subvencionuar, por do të ishte mirë që t'iu lejohet renovimi i pjesës së bodrumit për ofrimin e shërbimeve relaksuese për fëmijët që janë të prekur me autizëm.

Për çështjet e ngritura nga znj. Leonora Shabani - Bajraktari, Dren Kukaj, drejtor, dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, për periudhën nëntor-mars.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 1 kundër dhe 7 abstenime, u miratua Vendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, për periudhën nëntor-mars.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit komunal të aksionarëve të NPL-ve.

Mustafë Krasniqi diskutoi për këtë, duke thënë se për shkak të përgjegjësi të mëdha ligjore që ngarkojnë mbi anëtarët e komisioneve komunale të aksionareve të ndërmarrjeve publike lokale dhe punës shtesë që këta persona janë të detyruar ta bëjnë në kuadër të këtyre përgjegjësi, është vlerësuar që të njëjtit të kompensohen.

Ai propozoi që ky propozimvendim të votohet për miratim.

Vala Peshku bëri vërejtje rreth votimit të pikës paraprake, duke thënë se unë e kërkoja fjalën, por kryesuesi nuk ma ofroi mundësin që të diskutoj, dhe konsideroj se jemi ngutur për votimin e atij propozimi. Unë nuk e di që çka kemi votuar sot, se aty shkruan: *"Propozimvendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban për periudhën nëntor-mars"*, e aty nuk kemi vit as nuk kemi asgjë.

Sa i përket propozimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të NPL-ve, jam i thartur i asaj se nëse duam të kemi cilësi, atëherë edhe duhet paguar, prandaj e përkrahi këtë propozimvendim.

Sami Boroci shprehu rezervë lidhur me këtë propozimvendim, duke konsideruar se kjo mund të jetë konflikt interesi nëse ne votojmë për benifitet tona në këtë rast, kështu që kisha dashtë me marr një interpretim nga Zyra ligjore para se të merret vendim për këtë pikë.

Adrian Berisha tha se e përkrahu këtë iniciativë, që anëtarët e komisioneve komunale të aksionarëve të ndërmarrjet publike lokale, për angazhimin e tyre që e kanë, ta kenë një kompensim. Ne në këtë rast nuk po vendosim për veten, ne po vendosim për të gjithë aksionarët e përzgjedhur nga Kuvendi komunal në ndërmarrjet publike.

Agim Gashi tha se e përkrahu këtë propozimvendim, por para disa viteve janë bërë përpjekje të ngjashme dhe nuk është gjetur bazë ligjore, sepse ligjet që e rregullojnë fushën e financave e kanë penguar një proces të tillë. Çaktimi i vlerës së pagesës nuk është i njëjtë, ai dallon prej një ndërmarrje në tjetrën, dhe mendoj se kjo nuk është korrekte, kur vlera e pagesës së aksionarit është dyfish më e madhe se e këshilltarit komunal. Po të kishte qenë një propozim pak më i përafërt dhe i ngjashëm në rolin e aksionarit, si pagë e dytë në rolin e këshilltarit komunal, do të ishte dukur më e arsyeshme edhe propozimi, edhe marrja e vendimit.

Sokol Berisha tha se po të kishte qenë më e formuluar kjo pjesa e aksionarit, e kisha votuar këtë propozim, por diçka nuk po më duket e arsyeshme pagë minimale, kur e dimë se roli i aksionarit në ndërmarrje është thujse i kotë, kështu që nuk do ta votoj këtë propozim.

Naim Hoxha shprehu mendimin se ky propozim për të qenë sa më i përafërt, duhet që vlera e pagesës të jetë e njëjtë për të gjithë anëtarët e komisioneve të aksionarëve, kështu që me një vlerë të njëjtë të gjithë asamblastët do të jenë në pozitë të ngjashme.

Leonora Shabani- Bajraktari tha se do të ishte më e arsyeshme që aksionarët të kompensoheshin me nga një mëditje, pra të obligohen që në muaj ta mbajnë vetëm një mbledhje, të paguhen vetëm për atë mbledhje.

Valbona Ajeti tha se është shumë e drejtë që ky propozim që erdhi në Kuvend për diskutim dhe për këtë vendosim të gjithë bashkërisht, e për çështje tjera se a është konflikt interesi a nuk është për këtë vendos Ministria.

NoI Nushi shprehu mendimin se aksionarët duhet të kompensohen për shkak të përgjegjësisë që ata e kanë në ato ndërmarrje, andaj nuk jam i mendimit se ata duhet të kompensohen me mëditje për mbledhjet që i mbajnë.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve të NPL-ve.

Pika e dymbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje

Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

-Banorët e fshatrave Tenezhdoll dhe Prugovc, kërkojnë që të jetë një linjë e transportit të trafikut urban, pasi që ata po ndihen të diskriminuar, andaj kërkoj që banorëve të kësaj zone rurale t'iu bëhet një zgjidhje.

-Kërkoj që në zonat rurale të bëhet ndriçimi i rrugëve, pasi që në ato rrugë janë të vendosura shtyllat, por ndriçimi mungon.

Misad Vitija, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

-Në fshatin Hajvali janë dy rrugë që lidhen me rrugën "Ymer Gashi", janë të pashtuara, ku kanë nevojë për rregullim të kanalizimit dhe shtruarjen e kubzeve.

Po ashtu, është më se e nevojshme që të ndërtohet edhe një rrugë për në lagjen "Pepaj" në fshatin Busi, pasi që për këtë rrugë ekziston projekti.

Kërkoj të dijë arsyen e mos fillimit të ndërtimit të kësaj rruge.

Sokol Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

-Banorët afër rrugës "Sylejman Vokshi" kanë shumë telashe për kyqjen në këtë rrugë, pasi që ajo është e pashtuar. Kërkoj që të merren masa dhe të shtrohet ajo rrugë në kubze.

- Po ashtu, një problem që është tejet shqetësues për lagjet e qytetit, janë edhe qentë endacakë që paraqesin një rrezik të madh për qytetarët. Kërkoj që për mbledhjen e radhës së Kuvendit ky problem të futet në rendin e ditës për shqyrtim.

Agim Gashi tha se, lidhur me vendimin që u miratua për lirim nga pagesa e qytetarëve për linjat në trafikun urban, ka një keqkuptim, por ndoshta propozuesi nuk ka qenë i vëmendshëm po ashtu edhe ne si votues, sepse një vendim i njëanshëm diskriminon pjesën tjetër të qytetarëve të cilët, operojnë me linjat e kontraktorëve të tjerë. Do të ishte mirë që kjo të analizohet pak më mirë, të korrektohet. Pra mendoj se propozuesi ka pasur parasysh t'iu ndihmoj të gjithë qytetarëve të cilët udhëtojnë edhe me kontraktorë të tjerë të linjave të ndryshme në komunën e Prishtinës.

Rifat Deri, për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

-Para dy viteve kam kërkuar ndërtimin e dy rrugëve për qasjen në kalanë e Keqekollës dhe për në kalanë e Marecit. Për këto kërkesa deri më tani nuk kam marrë asnjë përgjigje. Ndërtimi i këtyre rrugëve do të ndihmonte në masë zhvillimin e turizmit në atë pjesë rurale të komunës.

Naim Hoxha për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

-Banorët afër rrugës "Gazmend Zajmi" kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me vendosjes e kapakëve të pusetave në rrugë, të cilat nuk janë të fiksuara ashtu si duhet. Me rastin e kalimit të automjeteve aty bëhet zhurmë dhe është tejet shqetësuese për banorë, andaj kërkoj që të bëhet rregullimi i këtyre pusetave.

-Pse nuk vendosen kunjat anti -parking në rrugën "Gazmend Zajmi", pasi që në trotuar parkohen automjete dhe pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Kërkoj që kunjat anti- parking të vendosen në atë pjesë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta**

Faqe 16 nga 17

